



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur me dt. 22/10/.2020, ndërmjet:

1. Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (Voice of Roma, Ashkali and Egyptians) si Organizatë Joqeveritare me numër të regjistrimit **5113364-1** pranë Ministrisë së Administratës Publike, me adresë në rrugën Milosa Obilica në Graçanicë, 10500 Prishtinë, të cilën e përfaqëson Drejtori Ekzekutiv Isak Skenderi, në tekstin vijues VORAE;

2. Komuna e Gjakovës e përfaqësuar nga kryetari Ardian Gjini në tekstin vijues Komuna.

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është ngritja e njohurive të zyrtareve komunal rreth antigjipsizmit si formë specifike e racizmit dhe edukimi për pasojat me të cilat po perballen komunitetet ashkali, egjiptian dhe rom si rezultat i veprimeve antigjipsiste nga komuniteti shumicë.

Kjo ndërhyrje ka të bëjë me edukimin kundër antigjipsizmit e cila është pjesë e misionit për një kulturë universale për të drejtat e njeriut. Realiteti i përhapur i antigjipsizmit në Kosovë e bënë të domosdoshëm adresimin e këtij fenomeni, jo sepse diskriminimi ndaj romëve është i ndryshëm nga diskriminimet e grupeve tjera por sepse realiteti ka dëshmuar se antigjipsizmi direkt ose indirekt ka ndikuar edhe në arsimimin e komuniteteve ashkali, rom dhe egjiptian në Kosovë.

1. Kushtet e përgjithshme

VoRAE ka për qëllim që të adresojë antigjipsizmin si fenomen i cili ndikon në situatën socio-ekonomike të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian e sidomos te institucionet e nivelit lokal që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta.

Ne jemi të vetëdijshëm që pjestaret e këtyre tre komuniteteve njohuritë bazike për realizimin e të drejtave të njeriut i kanë të mangëta, andaj po synojmë që zyrtaret komunale pas trajnimit nga stafi i VORAE të ndikojnë në përmbushjen e kërkesave dhe realizimin e të drejtave drejt ofrimit të shërbimeve komunale sa ma cilësore karshi pjestareve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Gjakovës.

Prandaj VoRAE do të ofrojë ekspertizën e saj përmes sesioneve informuese që do të organizojë për zyrtarë komunal në komunën e Gjakovës si komuna me më së shumti numër të banorëve nga rradhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

3. Veprimet konkrete të Komunës

- Pas nënshkrimit të marrëveshjes Kryetari i Komunës do të përcaktojë Zyrtarin apo edhe drejtorinë Përgjegjëse me të cilin VORAE do të ketë bashkëpunim të ngushtë në realizim të sesioneve informuese me zyrtar komunal.
- Komuna duhet të njoftojë zyrtaret për bashkëpunimin me VoRAE dhe të ndajë MOU e bashkëpunimit me ta.
- Komuna do ti obligojë zyrtarët komunal për pjesëmarrje në sesione informuese.
- Komuna do të sigurojë hapsirat për mbajtjen e sesioneve informuese.

4. Veprimet konkrete të VORAE

- VoRAE do të ofroj ekspertizën profesionale sa i përket antigjipsizmit dhe do të ndajë njohuritë e saj me zyrtarët komunal.
- VoRAE obligohet që të ndajë materialet e antigjipsizmit me zyrtarët komunal dhe Komunën.
- VoRAE obligohet që të vlerësojë nivelin e njohurive të zyrtareve komunal për antigjipsizmin përmes pyetësorëve që do të shpërndahen në fillim dhe në fund të sesioneve.

5. Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi dhe është e plotfuqishme që nga dita e nënshkrimit dhe është valide deri në përfundim të sesioneve informuese që pritet të organizohen deri në dhjetor 2021.

6. Kushtet e Veçanta

Kjo marrëveshje është bërë në dy kopje origjinale për secilën palë nga një formë.

Në rast se kjo marrëveshje nuk respektohet atëherë palët janë të obliguara të njoftojnë palën tjetër 30 ditë më herët për shpërndarjen e marrëveshjes.

PALËT

KOMUNA E GJAKOVES



Ardian Gjini
Kryetar



OJQ "VORAE"

O.B. Hatake

Isak Skenderi
Drejtorekzekutiv

